

Balada e murimit në studimet shqiptare

Olimbi Velaj*

Përmbledhje

Balada e murimit është një nga më të vjetrat dhe më të njohurat në folklorin shqiptar. Motivi i saj është sakrifikimi i një gruaje të re në themelet e një kalaje, të një ure, ose të një objekti tjetër të rëndësishëm për etninë. Përhapja e këtij motivi i kalon kufijtë ballkanikë.

Fqinjët e shqiptarëve, për rrethana më të favorshme historike, gjeopolitike dhe të tjera, kanë mundur të botojnë epet dhe këngët e tyre që përpara një shekulli e gjysmë, e bashkë me to edhe variantet e baladës së murimit. Variantet shqiptare të mbledhura e të botuara ishin gjithnjë në disavantazh, më të pakta në numër dhe të pa eksponuara siç duhet në literaturën e Evropës së asaj kohe. Në studimet e bëra në dekadat e fundit nga filologë dhe folkloristë shqiptarë vlerësohet veçanërisht legjenda për murimin në kalanë e Shkodrës.

Në këtë shqyrtim qëllimi është të evidentohet se si është studiuar kjo baladë, që nga koha e mbledhjes së saj e deri më sot, si ka evoluar dokumentimi i varianteve dhe çfarë progresi ka në interpretimin e tyre, referuar edhe studiuesve dhe shkollave që kanë influencuar më shumë.

Fjalë kyç: baladë, murimi, variantet, studimet, folklor, shqiptare, kala, ballkanike, studiues, letërsi

Një nga motivet më interesante dhe më të përhapura në Ballkan është ai i murimit të një njeriu në themelet e një vepre me rëndësi për etninë.

Të dokumentuara ose të mbërritura deri te ne nëpërmjet transmetimit brez pas brezi si legjenda, a balada, flijimet e njerëzve për t'u dhënë qëndrueshmëri ndërtimeve vazhdojnë të mbeten edhe sot e kësaj dite një çështje me interes për ata që merren me kulturën popullore. Jo pak ky motiv ka pasur ndikim në letërsi.

* *Ma. Olimbi Velaj, Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës, olimbivelaj@yahoo.com*

Kësisoj, ky “shqetësim” kthehet nga kureshtje për të njohur më shumë rreth kësaj çështjeje, në një sprovë për të paraqitur fakte dhe argumente që e ndriçojnë atë.

Që në krye të herës duhet thënë se ishte balada e murimit ajo që nxiti interesin për të shkuar te burimet jashtë artistike, te rrënjët e flijimit: te miti, te rituali, te riti dhe deri te zakoni, i cili ende sot e kësaj dite vijon të mbahet gjallë në Ballkan në formën e tij të zbutur, të zëvendësuar nga flijimi i një njeriu, në flijimin e një kafshe.

Duke qenë e lidhur ngushtë me atë moment tragjik të murimit të një njeriu në këmbim të qëndrueshmërisë së një objekti me rëndësi për njerëzit e rrethit të tij dhe për etninë e tij, balada e murimit ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të shumë fushave. Dhe prandaj nuk është e rastit që ajo mund të gjejë po aq vëmendje në studimet e folkloristëve, sa në ato të etnologëve, mitologëve, antropologëve, në studimet e arkeologëve e deri në fusha të tjera më “të largëta”.

Interesi për folklorin

Rreth dy shekuj më parë interesi për epopetë kombëtare u shtrua gati si imperativ kategorik në radhët e elitave kulturore të vendeve të Evropës. Koha e krijimit të shteteve kombëtare, theksi që vihej te gjuha dhe te kultura e çdo kombi, e bëri Romantizmin Evropian një promovues të epëve dhe sagave. Ethja për të “shpikur” saga, edhe kur ato nuk ekzistonin ishte në fakt një rezultante që nxori në sipërfaqe shumë legjenda të fjetura e të vjetra ndër popujt evropianë. Edhe ndër shqiptarë përpjekjet për të botuar epopenë kombëtare patën rezultatet e veta.

Entuziazmi që shkaktoi skocezi Xhejms Makferson (James Macpherson, 1736-1796) me “hilen” e tij të “zbulimit” të fragmenteve nga poezia e lashtë mbledhur në malësitë e Skocisë, sikur i vuri në garë shkrimtarët dhe studiuesit e kohës në kontinent, në një garë që zgjati afërsisht një shekull. Shtirja e gjoja përkthimit të poemave epike kelte të kalorësit dhe rapsodit legjendar Osian (Ossian), mbase nuk ishte një akt i ndershëm në vetvete. Por ishte një nxitës i mrekullueshëm për mbarë Romantizmin Evropian.

Pasioni për të kërkuar, shfaqur dhe rivlerësuar letërsinë gojore e shoqëroi jetën kulturore të një shekulli me një prurje mjaft të madhe dhe u dha dorë shkrimtarëve për hapësira të reja, ndoshta të pa imagjinuara deri atëherë.

Johan Volfgang fon Gëte (Johann Wolfgang von Goethe, 1749-1832) që adhuroes i madh i poezisë “osianike”. Dhe po kështu shkrimtarë e poetë nga më të mëdhenjtë në Evropë. Një paralele ishte edhe Gavril Dara i Riu, i cili teksta publikonte “Këngën e sprasme të Balës” pohonte se kishte njohur në përmbledhjen me këngë popullore të të gjyshit të tij, fragmente nga një poemë e lashtë epike shqiptare e një rapsodi malësor që quhej Balë.

Figurat më të spikatura të Rilindjes Shqiptare u morën me këtë “detyrë” të shtruar tashmë për përmbushje përpara tyre. Përpyekjet e bëra nga thujse çdo autor i Rilindjes për të nxjerrë në pah vlerat e kombit të vet konvergjuan në një prurje mjaft të madhe dhe në botime të posaçme, që sot janë bazat e referencës së çdo studiuesi serioz që merret me kulturën popullore.

De Rada me ndihmesën dhe “networkun” që krijoi nëpërmjet letërkëmbimeve e lidhjeve direkte me figurat më të spikatura shqiptare e evropiane të albanologjisë në shekullin e nëntëmbëdhjetë, padyshim që renditet ndër pionierët për punën e tij të madhe në lidhje me rivlerësimin dhe botimin e lëndës folklorike. Emri i tij shfaqet si katalizator, siç do ta përshkruajë Robert Elsie¹ një shekull më vonë.

De Rada mbajti lidhje me Thimi Mitkon (1820-1890), me Zef Jubanin (1818-1880), me Sami Frashërin (1850-1904) dhe me Dora D'Istrian (1828-1888). Ai ishte gjithashtu në kontakt me studiues të tjerë, të huaj të interesuar për Shqipërinë, si albanologu francez Ogyst Dozon (Auguste Dozon, 1822-1891), baroneshën Jozefin fon Knorr (Josephine von Knorr, 1827-1908) dhe me gjuhëtarin austriak Gustav Majer (Gustav Meyer, 1850-1900). Ai pati inkurajimin edhe të poetit e politikanit francez Alfons de Lamartin (Alphonse de Lamartine, 1790-1869), të poetit provansal Frederik Mistral (Frederic Mistral, 1830-1914).

¹ Elsie, Robert, *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë- Pejë, 1997, f. 159-161.

Pak dekada pas publikimit dhe suksesit të “Këngëve të Milosaos”, poemës së tij që është e krahasueshme me romanin në vargje ndër letërsitë e mëdha të kohës, De Rada publikoi në Napoli “Lashtësia e kombit shqiptar dhe afëria e tij me grekët e latinët” më 1864 (Antichita della nazione Albanese e sua affinita con gli Elleni e i Latini). Dhe më 1866 botoi në Firenze “Rapsodi nga një poemë shqiptare të mbledhura nga ngulimet e krahinës së Napoli” (Rapsodie d’un poema Albanese raccolte nelle colonie del Napoletano).

Këto botime, përpos veprës së mirëfilltë letrare qëndrojnë në të njëjtën lartësi dhe komunikojnë me dijetarët bashkëkohës të kontinentit në të njëjtën gjatësi vale.

Në këto vite, studiuesit evropianë që u morën me kulturën popullore të popujve të Ballkanit, kur u referoheshin shqiptarëve, citonin më së shumti këto vepra të De Radës. Madje në disa raste, jo pa zili.

Dokumentimi i baladës së murimit

Studiuesit që janë marrë me baladën e murimit në rajonin e Ballkanit kanë pasur gjithmonë në dorë një variant të botuar herët nga Vuk Karaxhiç për murimin në kështjellën e Shkodrës. Balada “Ndërtimi i kalasë së Shkodrës” mendohet t’i ketë mbërritur Gëtes në vitin 1824, nëpërmjet Jakob Gemit, i cili e kishte përkthyer nga përmbledhja e Karaxhiçit.

Kërkimet shqiptare për baladën e murimit kanë nisur pikërisht në vitet 1868-1978 nga Thimi Mitkoja, ashtu si edhe dokumentimet e saj në “Bleta shqiptare”. Thimi Mitkos i takon edhe merita si mbledhës dhe sistemues.

Më pas s’mund të lihen pa përmendur përpjekjet e fretërve françeskanë dhe rezultatet që përfunduan me botimin e “Visareve të Kombit”. Emrat e Donat Kurtit, Bernardin Palajt, Gjergj Fishtës, Ernest Koliqit zënë kryet e vendit për sa i përket mbledhjes dhe publikimit të folklorit shqiptar, e midis kësaj lënde edhe të varianteve të baladave.

Një brez tjetër, që spikati tashmë shumë më tepër në studimin dhe krahasimin e lëndës folklorike shqiptare është ai i Eqerem Çabejt, Aleks Budës, Idriz Ajetit deri te Rexhep Qosja.

Studiues si Qemal Haxhihasani, Zihni Sako, Vili Kamsi, Jorgo Panajoti, Gjergj Zheji, Mark Tirta fiksohen më dukshëm sepse merren të paktën një herë drejtpërdrejt me baladën e murimit ndër shqiptarë. Shkrimtarët e spikatur si Ismail Kadare e Fatos Arapi, dalin edhe me monografi studimesh të posaçme për folklorin, e që merren jo pak me baladën e murimit. Vepra e Kadaresë shquhet për rimarrjen e motivit të flijimit tashmë në letërsi, në një rast për urë dhe simbolikisht në kështjellë në rastin tjetër.

Ndërsa Anton Papeleka e Sadri Fetiu në botimet e tyre hyjnë më thellë dhe ndriçojnë në një mënyrë më të plotë vetë baladën e murimit.

Pas shtegut të kërkimeve për këtë baladë, që e hapi Thimi Mitkoja, më pas këto u zgjeruan dhe deri në vitin 1965 janë regjistruar tekste (nga të cilat 22 inçizuar; 19 për kala dhe 13 për ura) në 150 qendra të banuara. Nga analiza e këtyre teksteve rezulton se më tepër balada shtjellohet për kala e ura, kurse numri i baladave për kisha është relativisht i vogël.²

Ashtu si edhe vërejnë mjaft studiues, është e qartë se ka një dallim midis studimeve jashtë institucionale dhe atyre që u kryen si “sipërmarrje” shkencore, nëse guximi për ta përdorur këtë emërtim nuk është i tepërt.

Sot në qarkullim janë disa studime që e kanë ndriçuar baladën e murimit në mjaft aspekte. Por ajo që të bën përshtypje është se thuajse në gjithë materialin e botuar që qarkullon nuk ka ndonjë shumësi variantesh të kësaj balade. Nuk shihet mirë raporti midis varianteve shqiptare dhe atyre të huaja në rastin kur merren për shqyrtim autorë të tjerë joshqiptarë dhe qasja ndaj kësaj balade, mbetet në shumicën dërrmuese deskriptive.

Vetëm vitet e fundit, studiues si Shaban Sinani e Ardian Klosi, merren në mënyrë origjinale me baladën dhe me lidhjet e saj me ritin e flijimit. Duke e ngushtuar rrethin e detyrave të cilat ata marrin përsipër të zgjidhin në punimet e tyre, arrijnë të bëhen inspirues për

² Sako, Zihni, “Balada shqiptare për murimin dhe elementet e saj të përbashkëta me motërzimet ballkanike”, *Studime filologjike*, 1967, nr 2, f. 87-92.

kërkime të tjera dhe nxitin imagjinatën e më të rinjve për të shkelur në këtë shteg të sapo hapur, që është kaq origjinal.

Në këtë vështrim ata rrokin edhe gjithë ç'qarkullon në studimet bashkëkohore e kështu e sjellin çështjen e baladës së murimit (për aq sa e marrin në konsideratë) në një kontekst krejt tjetër.

Rimarrja e baladës së murimit njëherësh me ritin e flijimit, përmbys raportet e mëparshme, duke vendosur përparësinë e kronologjisë: pra më parë shqyrtohet flijimi në disa nga aspektet e tij dhe mandej shkohet te balada, si një lëndë e cila buron prej këtij riti.

Influenca në studime

Sir James George Frazer (1854-1941), një antropolog social nga Skocia, që ai që influenoi në studimet nga fazat e hershme të studimet bashkëkohore të mitologjisë dhe të krahasimit në religjion. Puna e tij më e famshme mbetet studimi "The Golden Bough" (1890), që bazohet mbi dokumente e detaje të ngjashme të magjive dhe besimeve fetare në gjithë botën. Frazer e pozicionon progresin e besimit human në tri stadi: në atë primitiv magjik, në kthimin të religjionit dhe në kthimin të shkenca.

Mund të përmendet si çelës ndihmues edhe perceptimi i hapur nga pionieri i strukturalizmit antropologjik (por jo vetëm), Claude Lévi-Strauss, përfundimet e të cilit pas vitit 1958 gjetën terren aplikimi edhe në disiplina të tjera të ngjashme. Ai e konsideroi kulturën një sistem të komunikimit simbolik, që duhej hetuar me metoda të cilat më parë nuk qenë përdorur. Paralelet me Ferdinand Dë Sosyrin dhe kursin e tij të gjuhësisë së përgjithshme u shtrinë në të gjitha fushat e shkencave humane.

Për më herët duhen përmendur teoritë mbi të cilat u operua në folklor për baladat. Edhe pse baladat nuk "u përfshinë" në teorinë e shtegtimit të motiveve të Teodor Benfejit (Theodor Benfey) dhe as në teorinë e "përpunimit" sipas morfologjisë së përrallës, të rusit Aleksandër Prop (Alexander Propp), sërish ato nuk mbetën jashtë këtyre trajtimeve.

Benfeji, filolog gjerman (1809-1881) që e kaloi një pjesë të jetës në lindje, u mor mjaft me teorinë se një pjesë e madhe e folklorit evropian

ka një origjinë motivesh indiane. Po kështu edhe Uilliam Cloustron (1843-1896). Të tjerë ndjekës qenë Emmanuel Cosquin dhe Joseph Jacobs (1854- 1916). Max Muller ishte gjithashtu ndjekës i kësaj teorie, edhe pse kurrë nuk vuri këmbë në Indi.³

Por ndër studiuesit ballkanikë të baladës së murimit duket se këto teori nuk janë anashkaluar. Ato sillen në një drejtim tjetër shtegtimi, si për shembull rasti i studiuesit Mihail Arnaudov⁴ që e ndryshon pak drejtimin e shtegtimit, nga Greqia drejt veriut dhe lindjes së Ballkanit. Ndërsa morfologjia e përrallës, arketipi dhe variantet janë thuajse të pranueshme nga çdo studiues që është marrë me baladën e murimit në Ballkan.

Ndër studiuesit e tjerë, më të vonë në kohë, interpretimi nga kënde të tjera i baladës, nxjerr në sipërfaqe të tjera rezultate. Kështu Julia Kristeva⁵ me pozicionin e saj “feminist” ka hapur një mënyrë të re të vështruarit të baladës. Po ashtu Alan Dundes⁶, flet për një qasje gjinore ndaj kësaj balade. Kundrimi i baladës si një “duel” mes matriarkatit dhe patriarkatit, si dhe shumë çifte të tjera kundërvëniesh, e bëjnë interesante qasjen ndaj saj.

Përfundim

Duke iu referuar një materiali të pasur për sa u përket studimeve etnologjike, mitologjike dhe antropologjike rreth baladës së murimit dhe baladës, vihet re se ka gjithmonë një lloj tendence për të “kombëtarizuar, privatizuar” disa variante dhe për të lënë jashtë vëmendjes disa të tjera. Variantet shqiptare kanë qenë gjithmonë më të pakta në qarkullim dhe një nga minuset ka qenë edhe mosnjohja e shqipes ose përkthimi i keq i varianteve në rastet kur ato kanë qenë të botuara.

³ Enciklopedia online Enkarta 2002, <http://www.encyclopedia.com/>

⁴ Arnaudov, Mikhail, *Oçerci po bllgarskija folklor*, Akademično Izdatelstvo, Sofje,1996, f. 687.

⁵ Jefferson, Ann and Robery, David, *Teoria letrare moderne*, Tiranë, 2004, f. 308-309.

⁶ Dundes, Allan, *Journal of American Folklore*, Vol. 108, 1995, f. 38-53.

Gjithsesi, deri tani prej studiuesve shqiptarë janë marrë në konsideratë në një masë të madhe të dhënat për sakrificën njerëzore, për kalimin e shkallëshkallshëm të saj në sakrificë talismanësh, hijeje, e pastaj në sakrificë kafshësh. Është trajtuar kalimi nga një formë në tjetrën. Janë paraqitur llojet e sakrificave, pagane dhe religjioze, karakteristikat e tyre dhe disa tipare në popuj e fe të caktuara. Dhe po ashtu është paraqitur së fundi edhe lidhja e ngushtë rit-baladë.

Bibliografia

- Arnaudov, Mikhail. *Oçerci po bllgarskija folklor*, Sofje, Akademično Izdatelstvo, (1996): 687
- Dundes, Alan. *Journal of American Folklore*, Vol. 108, (1995): 38-53
- Elsie, Robert. *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë- Pejë, (1997) : 159-161
- Enciklopedia online Enkarta 2002, www.encartaencyclopedia.com/
- Jefferson, Ann & Robery, David. *Teoria letrare moderne*, Tiranë, (2004): 308-309
- Sako, Zihni. "Balada shqiptare për murimin dhe elementet e saj të përbashkëta me motërzimet ballkanike", *Studime filologjike*, nr 2, (1967): 87-92